

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Kallëzimi në SPAK përfshin 16 degë të Thesarit, kërkohet zbardhja e gjithë zinxhirit të vendimmarrjes
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/10/16-dege-te-thesarit-ne-kallezimin-ne-spak-nen-hetim-ke-rkohet-zinxhiri-i-vendimmarrjes-per-pagat-e-magjistrateve/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 12:05:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	10 shtator 2026, 11:59:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 10 shtator 2026, 11:58:00 UTC → 10 shtator 2026, 12:00:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2f528dbac61206f7ab89341528870046c0a2849159777c42560cfa2b040815a4
TEKSTI	410a13d8c3f834458d86405b34f76ac3354df0f9aba681a8bcb57ba98e873391
PAMJA	5826ea7433984c905083abf984ac088aa305c7a1a120869a561133e9f94731c8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	352cae20fdeaa5dab6ffde74a377b7975295bf7a687e2ed0a86907fe22f746a
E MËPARSHMJA	5c312ecb6d07d5acc2482a6651f1fed80f29c29846839311785c44b27bc938f1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/352cae20fdeaa5dab6ffde74a377b7975295bf7a687e2ed0a86907fe22f746a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Kërko...

[Aktualitet Kryesore Të Fundit](#)

Ngërçi me pagat e magistratëve/ Kallëzimi në SPAK përfshin 16 degë të Thesarit, kërkohet zbardhja e gjithë zinxhirit të vendimmarrjes

10/09/2026 14:23



Detaje të reja dalin nga kallëzimi penal i depozituar në SPAK për bllokimin e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për muajin gusht 2026.

Njëzet nëpunës autorizues të gjykatave, së bashku me drejtues të shoqatave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kërkojnë hetimin e ministrit të Financave, Petrit Malaj, sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, Gentian Këri, si dhe drejtuesve të 16 degëve të Thesarit, për tre vepra penale të pretenduara: “shpërdorim detyre”, “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” dhe “mosekzekutim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”.

Në qendër të kallëzimit është pretendimi se strukturat e Thesarit nuk kishin kompetencë të vendosnin për ligjshmërinë e formulës së pagave dhe, për pasojë, as të bllokonin urdhërpagesat. Kallëzuesit argumentojnë se, edhe në rast mosmarrëveshjeje, administrata shtetërore duhej t'i drejtohej gjykatës dhe jo të pezullonte në mënyrë të njëanshme pagesat.



Sipas kallëzimit, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 17 shkurtit 2026 dhe përfundimit të afatit të lënë Kuvendit për ndërhyrjet ligjore, KLGJ dhe KLP kërkuar që nga 1 gushti paga referuese bazë të përlogaritë sipas formulës së përcaktuar në vendimin nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe parametrate të VKM-së nr. 325/2023. Kallëzuesit pretendojnë se moszbatimi i kësaj formule cenon drejtpërdrejt një vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese.

Një nga elementët që kërkohet të hetohet është komunikimi elektronik mes Ministrisë së Financave dhe degëve të Thesarit. Sipas kallëzimit, bllokimi i urdhërpagesave është pasuar nga një e-mail i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Gentian Këri, ndërsa SPAK-ut i kërkohet të administrojë korrespondencën dhe të përcaktojë se kush urdhëroi moskryerjen e pagesave dhe mbi çfarë baze ligjore

Kallëzimi ndalet veçanërisht edhe te roli i degëve të Thesarit. Sipas argumentimit të kallëzuesve, kontrolli që këto struktura ushtrojnë mbi shpenzimet buxhetore lidhet me verifikimin formal, dokumentar, të fondeve në dispozicion dhe përputhshmërinë e pagesës, por nuk u jep atyre të drejtën të rivlerësojnë përmbajtjen e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese apo formulën e pagës së përcaktuar në zbatim të tij.

Një tjetër element që kallëzuesit kërkojnë të verifikohet nga SPAK lidhet me fondet për pagat e muajit gusht 2026. Sipas kallëzimit, gjykatat i kishin fondet e mjaftueshme për të përballuar pagat sipas formulës së re, por urdhërpagesat nuk u ekzekutuan nga degët e Thesarit. Për këtë arsye, SPAK-ut i kërkohet të verifikojë gjendjen e fondeve buxhetore në momentin e paraqitjes së urdhërpagesave, për të përcaktuar nëse bllokimi erdhi për shkak të mungesës së parave apo si rezultat i vendimmarrjes së zyrtarëve të kallëzuar.

Në pjesën përfundimtare, kallëzuesit i paraqesin SPAK-ut 14 veprime hetimore që kërkojnë të kryhen. Mes tyre janë administrimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimeve të KLGJ-së e KLP-së, marrja e shkrësive dhe korrespondencës së Ministrisë së Financave me Thesarin, si dhe dokumentacioni mbi procedurën e pagesave.

Po ashtu, kërkohet sekuestrimi dhe ekspertimi i gjurmëve elektronike në sistemin e Thesarit, për të identifikuar veprimet e kryera, përdoruesit që kanë ndërhyrë dhe kohën e këtyre veprimeve. SPAK-ut i kërkohet të administrojë edhe komunikimet elektronike dhe e-mail-et që lidhen me bllokimin e pagave.

Mes kërkesave është edhe pyetja e personave që kanë urdhëruar ose zbatuar mos-ekzekutimin e pagesave, ekspertimi financiar për të përcaktuar efektet e bllokimit, verifikimi nëse ka pasur ndërhyrje politike ose administrative, si dhe kryerja e çdo veprimi tjetër që SPAK e konsideron të nevojshëm për zbardhjen e plotë të rrethanave.

Kallëzuesit argumentojnë se paga e magjistratit nuk përbën vetëm një marrëdhënie financiare, por lidhet me garancitë e pavarësisë së gjyqësorit. Sipas tyre, bllokimi i pagave, nëse provohet se është bërë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duhet të hetohet për të përcaktuar nëse janë konsumuar veprat penale të pretenduara në kallëzim.

Top Channel

[Aktualitet »](#)

[Vidhnin makinat në Vlorë dhe Orikum, arrestohen dy autorët e dyshuar](#)
10/09 14:29

["Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustificueshme të rindërtimit". Rama me tone të ashpra: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social](#)
10/09 14:25

["Do jenë 6 kategori", Rama prezanton programin e ri për strehimin social: Do përdoren objektet e konfiskuara, si do të bëhet ndarja](#)
10/09 14:11

["Kopsht zoologjik në burgun e sigurisë së lartë"/ Deklarata e fortë e gazetarit: Luanë, pitbullat dhe arinjtë nëpër qeli, janë ndërtuar suita që jepen me qera](#)
10/09 13:20

[SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë](#)
10/09 13:19

[Video/ Me kallashnikov dhe pistoletë në lokal, dy të rinj kërcënojnë dhe dhunojnë një person në Shkodër](#)
10/09 13:12

[Kryesore »](#)

["Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustificueshme të rindërtimit". Rama me tone të ashpra: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social](#)
10/09 14:25

["S'do bëjnë më tendera siç kanë bërë"/ Taksat për kullat në qytete, Rama: Të ardhurat do shkojnë te Fondi i Strehimit, Enti i Banesave do kthehet në kompani publike](#)
10/09 14:22

["Do jenë 6 kategori", Rama prezanton programin e ri për strehimin social: Do përdoren objektet e konfiskuara, si do të bëhet ndarja](#)
10/09 14:11

[Hetimet ndaj Ballukut përplasën Kaprin dhe Bashën në "Shqipëria Live"/ Basha kundërshton Kaprin: Në fund vendos gjykata](#)
10/09 14:03

[Alarm në Detin e Kuq, Houthit synojnë ishullin që kontrollojnë nga rrugët më të rëndësishme detare. Rrezikohet tregu botëror i naftës](#)
10/09 13:38

[Pagat e gjyqtarëve, ministri Gogu: Zgjidhja vjen nga Kuvendi, kujdes shëndetin e buxhetit të shtetit](#)
10/09 13:30

Na ndiqni:

[Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel](#)
[Video »](#)

[Top Channel/ Skandal me "call-centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!](#)

[Top News – 'SPAK të hetojë Tigrat e energjisë', PD: ERE nuk i licencon, KESH u jep 20 mln euro](#)

[Top Channel/ "2 mijë kredi me interes 0, do i mbulojë Qeveria", Rama: 2 mijë të tjera me interes 3%](#)

[Top Channel/ Shqipëria në pushtetin e flakëve, Rama: Djallëzi njerëzor dhe fatkeqësi natyrore](#)

[Top Channel/ Rilindja 2.0, Rama: Do konfiskojmë objektet që shkelin rregullat për lejet e ndërtimit](#)

[Top News – 'Duan të hapin derën e Thesarit,' Rama mbron Malajn: Më kallëzoni edhe mua](#)
[Kryesore](#)

[LIVE/ Bllokimi i pagave të Drejtësisë, kryetarët e gjykatave kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, Petrit Malaj dhe 16 drejtues të Thesarit, Rama: Më shtoni dhe mua!](#)
11:34

[Protesta në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinë nis me tensione, banorët hyjnë në ambientet e Bankers Petroleum](#)
08:56

[Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin](#)

11:35

["Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit](#)
07:37

[Transferimi më i shtrënjtë në historinë e Real Madridit, por Diomande ende nuk ka debutuar si titullar](#)

09:44

[Më shumë lajme »](#)

[Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V](#)
[“Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit”/ Vance: Tarifat nuk mjaftojnë për premtimin e Presidentit](#)
[Sot gjyqi në Hagë. Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët](#)
[Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me “Demokratët Europianë”: A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?](#)
[Pronari ndodhej pak më tutje, vidhet automjeti në Pogradec, identifikohet dhe arrestohet autori](#)
[Kontrolle në Lezhë, bllokohet ‘bisha’ “Rolls-Royce”, nis hetimi pasuror për pronarin](#)
[“Ngushticës së Hormuzit do t’i vë emrin tim”/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit](#)
[Shqipëria e para në rajon për shkencë dhe matematikë, ana tjetër e rezultateve të PISA-s: Gjysma e 15-vjeçarëve nuk arrijnë nivelin bazë](#)
[Nisin hetimet për mjeken pas vdekjes së ikonës së muzikës greke, Mazonakis u përkeqësua në klinikën private, zbulohet trajtimi që po bënte](#)
[Video/ Barcelona e nis Champions-in me spektakël, shkatërron me pesë gola Feyenoordin në ndeshjen e parë](#)

- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)
- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)
- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)
- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)
- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Filks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)
- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)